

**VENDIM**  
**Nr. 242, datë 20.4.2023**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 234, DATË 20.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE PUNONJËSVE TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lidhjet I dhe II, të vendimit nr. 234, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, zëvendësohen me të njëjtët numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2023, përballohen nga fondet e kontingjencës, të miratuara për vitin 2023.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

**Lidhja I**

**Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi**

<b>Nr. rendor</b>	<b>Klasa e pagës</b>	<b>Paga bazë mujore për klasë</b>
1	I	40 000
2	II	41 000
3	III	41 800
4	IV	42 500
5	V	43 000
6	VI	44 000
7	VII	45 500
8	VIII	46 300
9	IX	47 000

**Lidhja II**

**Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi**

<b>Nr. rendor</b>	<b>Klasa e pagës</b>	<b>Paga bazë mujore për klasë</b>
1	I	40 000
2	II	41 000
3	III	41 800
4	IV	42 500
5	V	42 800
6	VI	43 200
7	VII	43 600
8	VIII	44 100
9	IX	44 800
10	X	45 300

11	XI	45 700
12	XII	46 000
13	XIII	46 700